

L I G J I P Ë R

AVOKATIN E POPULLIT

I. DISPOZITA TË GJITHSHME PËR

Neni 1

Me këtë ligj rregullohen kushtet për emërim dhe shkarkim, kompetencat dhe mënyra e punës e Avokatit të popullit.

Neni 2

Avokati popullit është organ i Republikës së Maqedonisë i cili i mbrohet të drejtat kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve dhe të gjithë personave tjerë kur ato u shkelen me akte, veprime dhe lëshim të veprimeve nga organet e administratës shtetërore dhe nga organet dhe organizatat tjera që kanë autorizime publike dhe i cili ndërmerr masa dhe veprime për mbrojtjen e parimeve të mosdiskriminimit dhe përfaqësimit adekuat dhe të drejtë të pjesëtarëve të bashkësive në organet e pushtetit shtetëror, organet e njësive të vetadministrimit lokal dhe të enteve dhe shërbimeve publike.

Neni 3

Avokati i popullit është i pavarur dhe i mëvetësishëm në kryerjen e funksionit. Avokati i popullit punët nga kompetencat e tij i kryen në bazë dhe në kuadër të Kushtetutës, ligjit dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën.

Në procedurë Avokati i popullit mund të thirret edhe në parimin e drejtësisë.

Neni 4

Selia e Avokatit të popullit është në Shkup.

Avokati i popullit ka vulë e cila përmban emrin dhe selinë, stemën dhe emrin Republika e Maqedonisë.

Në ndërtesën në të cilën është i vendosur Avokati i popullit vendoset emërtimi dhe selia, stema dhe flamuri i Republikës së Maqedonisë.

II. KUSHTET PËR EMËRIMIN DHE SHKARKIMIN E AVOKATIT TË POPULLIT

Neni 5

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, me propozim të komisionit kompetent të Kuvendit, e zgjedh dhe shkarkon avokatin e popullit me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i deputetëve, gjatë së cilës duhet patjetër të ketë shumicë votash nga numri i përgjithshëm i deputetëve që u takojnë bashkësive që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë. Avokati i popullit zgjedhet për kohëzgjatje prej tetë vjetësh me të drejtë edhe të një zgjedhje.

Avokati i popullit ka më shumë zëvendës. Numrin e zëvendësve të avokatit të popullit e cakton Kuvendi i Republikës së Maqedonisë me propozim të avokatit të popullit.

Zëvendësit e avokatit të popullit, me propozim të avokatit të popullit i zgjedh dhe i shkarkon Kuvendi i Republikës së Maqedonisë me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i deputetëve, gjatë së cilës patjetër duhet të ketë shumicë votash nga numri i përgjithshëm i deputetëve që u takojnë bashkësive që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë. Zëvendësit e avokatit të popullit zgjedhen me kohëzgjatje prej tetë vjetësh, me të drejtë edhe të një zgjedhje.

Procedura e zgjedhjes së avokatit të popullit dhe zëvendësve të tij fillon tre muaj para skadimit të mandatit të tyre.

Në rast të mungesës ose pengesës, avokatin e popullit e zëvendëson zëvendësi sipas radhitjes së caktuar nga avokati i popullit.

Neni 6

Për avokat të popullit mund të zgjedhet personi i cili i plotëson kushtet e përgjithshme të caktuara me ligj për themelimin e marrëdhënies së punës në organin e administratës shtetërore, jurist i diplomuar që ka përvojë pune mbi nëntë vjet në çështje juridike dhe aktiviteti i të cilit është dëshmuar në sferën e mbrojtjes së të drejtave të qytetarit dhe gëzon respekt për kryerjen e funksionit avokat i popullit.

Për zëvendës të avokatit të popullit mund të zgjedhet personi i cili i plotëson kushtet e përgjithshme të caktuara me ligj për themelimin e marrëdhënies së punës në organin e administratës shtetërore, jurist i diplomuar i cili ka përvojë pune mbi shtatë vjet në çështje juridike dhe aktiviteti i të cilit është dëshmuar në sferën e mbrojtjes së të drejtave të qytetarit dhe gëzon respekt për kryerjen e funksionit zëvendës i avokatit të popullit.

Gjatë zgjedhjes së zëvendësve të avokatit të popullit, pa i shkelur kushtet e përcaktuara me ligj, sigurohet përfaqësim adekuat dhe i drejtë i qytetarëve që u përkasin të gjitha bashkësive në Republikën e Maqedonisë.

Neni 7

Avokati i popullit para marrjes së funksionit jep deklaratë solemne para kryetarit të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, si vijon:

“Deklaroj se funksionin avokat i popullit do ta ushtroj me ndërgjegje dhe përgjegjësi dhe do t'i respektoj Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Maqedonisë“.

Neni 8

Funksioni avokat i popullit është jokohorent me kryerjen e ndonjë funksioni dhe profesioni tjetër publik ose me anëtarësimin në parti politike.

Neni 9

Avokati i popullit shkarkohet:

- 1) nëse vetë e kërkon atë;
- 2) nëse dënohet për vepër penale me dënim me burg pa kusht prej së paku gjashtë muaj;
- 3) se përgjithmonë e humb aftësinë psiko-fizike për kryerjen e funksionit avokat i popullit që vërtetohet në bazë të mendimit dhe konstatimit të institucionit kompetent shëndetësor;
- 4) nëse i plotëson kushtet për pensionim sipas moshës, dhe

5) për shkak të kryerjes së funksionit avokat i popullit në mënyrë joprofesionale, të njëanshme dhe të pandërgjegjshme.

Neni 10

Dispozitat nga nenet 7, 8 dhe 9 të këtij ligji kanë të bëjnë edhe për zëvendësit e avokatit të popullit.

III. KOMPETENCAT DHE MËNYRA E PUNËS

Neni 11

Avokati i popullit në kryerjen e detyrave nga kompetenca e tij ndërmerr masa dhe veprime për të cilat është i autorizuar me këtë ligj për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve ose mbrojtjen e parimeve të mosdiskriminimit dhe përfaqësimit adekuat dhe të drejtë të qytetarëve që u përkasin të gjitha bashkësive kur ato u janë shkelur nga organet nga neni 2 i këtij ligji .

Neni 12

Avokati i popullit ndërmerr masa dhe veprime për mbrojtjen nga zvarritja e pa arësyeshme e proceseve gjyqësore ose të kryerjes së punëve të shërbimeve gjyqësore me papërgjegjësi dhe pa ndërgjegje, duke mos i cenuar principet e mëvetësisë dhe pavarësisë së pushtetit gjyqësor.

Avokati i popullit nuk vepron për lëndë për të cilat procesi gjyqësor është në vijim, përveç rasteve nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 13

Procedura për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve pranë avokatit të popullit ngritet me dorëzimin e parashtrësës.

Secili person mund t'i paraqesë parashtrësë Avokatit të popullit kur të vlerësojë se i janë shkelur të drejtat dhe liritë kushtetuese dhe ligjore ose kur janë shkelur parimet e mosdiskriminimit dhe përfaqësimit adekuat dhe të drejtë të pjesëtarëve të bashkësive në organet sipas nenit 2 të këtij ligji.

Avokati i popullit mund të ngrejë procedurë edhe me iniciativë të vet, nëse vlerëson se qytetarëve u janë shkelur të drejtat kushtetuese dhe ligjore të përcaktuara në nenin 2 të këtij ligji.

Neni 14

Në procedurë para Avokatit të popullit gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik.

Në procedurë që mbahet para Avokatit të popullit gjuhë tjetër që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabeti i saj, gjithashtu është gjuhë zyrtare.

Dispozitat e Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative që kanë të bëjnë për përdorimin e gjuhëve në mënyrë adekuate aplikohen edhe në procedurën para Avokatit të popullit.

Neni 15

Secili person në komunikim me Avokatin e popullit mund të përdorë njërën nga gjuhët zyrtare dhe alfabetin e saj, ndërsa Avokati i popullit përgjigjet në gjuhën

maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën zyrtare dhe alfabetin që e përdor paraqitësi i parashtresës.

Neni 16

Parashtresa drejtuar Avokatit të popullit duhet të jetë e nënshkruar dhe të përmbajë të dhëna personale për paraqitësin dhe t'i përmbajë rrethanat, faktet dhe dëshmitë në të cilat është bazuar parashtresa.

Në parashtresë duhet të paraqiten organi, organizata, enti ose personi për të cilin bëhet parashtresa, si dhe të theksohet se a ka paraqitur masa juridike dhe cilat masa juridike i ka paraqitur parashtruesi.

Parashtresa për ngritjen e procedurës paraqitet me shkrim ose gojarisht në procesverbal.

Parashtresa me të cilin inicohet procedura nuk ka formë të përcaktuar.

Paraqitësi i parashtresës lirohet nga pagesa e taksës për procedurën para Avokatit të popullit.

Neni 17

Avokati i popullit është i detyruar ndaj parashtresës të veprojë me ndërgjegje, paanshmëri, efikasitet dhe me përgjegjësi.

Gjatë procedurës për parashtresën Avokati i popullit nga palët e interesuara është i detyruar t'i grumbullojë të gjitha faktet dhe dëshmitë që kanë rëndësi esenciale për të marrë vendim për parashtresën.

Neni 18

Avokati i popullit gjatë procedurës për parashtresën është i detyruar ta respektojë sekretin dhe të drejtën private të të dhënave që kanë të bëjnë me parashtruesit sipas nenit 16 të këtij ligji.

Neni 19

Avokati i popullit, duke vepruar ndaj parashtresës, mundet:

- të mos ndërmerr procedurë,
- të ndërmerr procedurë, dhe
- ta ndalojë ose ta ndërprejë procedurën.

Neni 20

Avokati i popullit nuk do të ndërmerr procedurë për parashtresën:

- nëse parashtresa është anonime, përveç nëse bëhet fjalë për çështje të interesit të përgjithshëm;
- nëse me parashtresën ofendohet organi ose keqpërdoret e drejta e dorëzimit të parashtresës;
- nëse parashtresa nuk është e kompletuar dhe nëse paraqitësi pas paralajmërimit paraprak nga Avokati i popullit nuk e ka plotësuar parashtresën;
- nëse nga parashtresa konstatohet se bëhet fjalë për rast më pak të rëndësishëm i cili edhe pas analizave të kryera nuk do të mund të japë rezultate përkatëse;
- nëse nga vetë parashtresa, rrethanat, dëshmitë dhe faktet e paraqitura rezultojnë se nuk bëhet fjalë për shkeljen e lirive dhe të drejtave kushtetuese dhe ligjore të parashtruesit ose personit në emër të të cilit paraqitet parashtresa nga organet sipas nenit 2 të këtij ligji;
- nëse nuk është kompetent të veprojë;

- nëse nga veprimi ose vendimi i fundit i organit, organizatës ose entit ka kaluar më shumë se një vjet, përveç nëse vlerëson se paraqitësi e ka lëshuar afatin për shkaqe të arsyeshme dhe

- nëse për lëndën e parashtresës është në rrjedhë e sipër procedurë gjyqësore, përveç punëve nga neni 12 paragrafi 1 i këtij ligji .

Kur Avokati i popullit nuk ndërmerr procedurë për parashtresën sipas paragrafit 1 të këtij neni është i obliguar në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të parashtresës ta informojë paraqitësin e parashtresës dhe t'ia sqarojë shkaqet për të cilat e hedh parashtresën dhe sipas mundësive t'ia sqarojë mënyrën se si mundet ta realizojë të drejtën.

Neni 21

Avokati i popullit do të ndërmerr procedurë për parashtresën e paraqitur ose me iniciativë personale nëse nga konstatimet, dëshmitë dhe faktet të paraqitura me parashtresë ose nga njohuritë e fituara në mënyrë tjetër ka bazë të rezultojë se nga ana e organeve nga neni 2 i këtij ligji janë shkelur të drejtat kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve ose është shkelur parimi i mosdiskriminimit dhe përfaqësimit përkatës dhe të drejtë të përfaqësuesve të bashkësive.

Nëse Avokati i popullit ndërmerr procedurë me iniciativë personale ose nëse person tjetër në emër të të dëmtuarit i drejtohet me parashtresë, për ngritjen e procedurës është i duhur pëlqimi nga i dëmtuari të cilit i janë shkelur të drejtat ligjore dhe kushtetuese ose janë shkelur parimi i mosdiskriminimit dhe përfaqësimit adekuat dhe të drejtë të pjesëtarëve të bashkësive.

Kur Avokati i popullit ndërmerr procedurë me iniciativë personale lidhur me shkeljen e të drejtave dhe lirive të një numri më të madh të qytetarëve, të të miturve, të pafuqishmëve dhe personave me aftësi të humbura afariste, nuk është i nevojshëm pëlqimi nga paragrafi 2 i këtij neni. Për ngritjen e procedurës Avokati i popullit i informon personat me të cilët ka të bëjë ajo, në afat prej 15 ditësh nga dita e ngritjes së procedurës.

Neni 22

Kur Avokati i popullit vendos të ndërmerr procedurë e informon paraqitësin e parashtresës në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të parashtresës.

Neni 23

Avokati i popullit do ta ndalojë ose ndërprejë procedurën e parashtresës:

- nëse pas mbarimit të procedurës për parashtresën konstatohet se nuk ka të bëjë me shkeljen e të drejtave dhe lirive kushtetuese dhe ligjore të paraqitësit nga organet sipas nenit 2 të këtij ligji;

- nëse gjatë procedurës ndaj parashtresës paraqitësi ndërmerr procedurë gjyqësore;

- nëse paraqitësi i parashtresës nuk tregon interesim për vazhdimin e mëtejshëm të procedurës;

- nëse paraqitësi gjatë procedurës e tërheq parashtresën;

- nëse gjatë procedurës paraqitësi i parashtresës ka vdekur, përveç nëse trashëgimtarët nuk kërkojnë vazhdimin e procedurës së filluar; dhe

- nëse e drejta e paraqitësit në ndërkohë është realizuar.

Kur Avokati i popullit do ta ndërprejë ose ndalojë procedurën e parashtresës është i obliguar që menjëherë e më së voni në afat prej 15 ditëve nga dita e paraqitjes së

rrethanave për ndalimin ose ndërprerjen e procedurës ta informojë paraqitësin e parashtresës dhe t'ia sqarojë arsyet për se ndërpritet ose ndalohet procedura dhe sipas mundësive t'ia sqarojë mënyrën se si mund ta realizojë të drejtën.

Neni 24

Për shqyrtimin e parashtresës, Avokati i popullit në kuadër të kompetencave të tij, në organet nga neni 2 i këtij ligji, mund t'i ndërmarrë masat dhe aktivitetet si vijon:

- të kërkojë sqarime të nevojshme, informata dhe dëshmi për shkaqet e parashtresës;
- të hyjë në lokalet zyrtare dhe të kryejë shikimin e drejtpërdrejtë në lëndët dhe punët nga kompetenca e tyre;
- të thërrasë në bisedë person të zgjedhur ose të emëruar, personin zyrtar dhe çdo person tjetër që mund të japë të dhëna të caktuara gjatë procedurës;
- të kërkojë mendim nga institucionet kompetente dhe shkencore; dhe
- të ndërmarrë masa dhe aktivitete tjera të përcaktuara me ligj ose rregullativë tjetër.

Sqarimet e kërkuara, informatat dhe dëshmitë nga paragrafi 1 alineja 1 e këtij neni, organet nga neni 2 të këtij ligji janë të obliguara t'ia paraqesin Avokatit të popullit menjëherë, ose së paku në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës për dërgimin e të dhënave. Nëse nga arsyet objektive janë të penguar që ta bëjnë këtë, janë të obliguar pa prolongim ta informojnë Avokatin e popullit për shkaqet për të cilat nuk kanë mundësi të veprojnë.

Nëse Avokati i popullit vlerëson se shkaqet nga paragrafi 2 të këtij neni janë të arësyeshme do të caktojë afat të ri për dorëzimin e sqarimeve, informatave dhe dëshmimeve të kërkuara.

Refuzimi dhe mosrespektimi i kërkesave të Avokatit të popullit për marrjen e vendimeve nga paragrafi 2 të këtij neni konsiderohet për pengim të punës së Avokatit të popullit.

Neni 25

Avokati i popullit, për pengimin e punës nga neni 24 paragrafi 4 me informatë të veçantë, mundet ta informojë drejtpërdrejtë organin më të lartë, funksionarin që udhëheq me organin nga neni 2 i këtij ligji, ose Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, dhe nëse ata nuk ndërmarrin masa të duhura Kuvendin e Republikës së Maqedonisë.

Avokati i popullit mund, kur është konstatuar shkelja e të drejtave dhe lirive kushtetuese dhe ligjore, që me shpenzime të organit nga neni 2 i këtij ligji, me të cilin ka të bëjë lënda ta publikojë rastin në mjetet e informimit publik.

Neni 26

Personat nga neni 24 paragrafi 1 alineja 3 e këtij ligji janë të obliguar të paraqiten në ftesën e Avokatit të popullit dhe t'i japin sqarimet e duhura lidhur me parashtresën e paraqitur.

Me kërkesë të Avokatit të popullit, kryetari i Republikës së Maqedonisë, kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, kryetari i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe funksionarët tjerë që udhëheqin me organe nga neni 2 i këtij ligji, janë të obliguar ta pranojnë pa shtyrje.

Neni 27

Organet nga neni 2 të këtij ligji janë të obliguara të bashkëpunojnë me Avokatin e popullit dhe me kërkesë të tij t'ia sigurojnë të gjitha dëshmitë, të dhënat dhe informatat, pa dallim nga shkalla e besueshmërisë dhe t'ia mundësojnë zbatimin e procedurës.

Avokati i popullit është i obliguar ta ruajë sekretin shtetëror dhe zyrtar në mënyrë dhe kushte të përcaktuara me ligj dhe me rregullativë tjetër.

Neni 28

Avokati i popullit mund t'ua japë mendimin e tij organeve nga neni 2 të këtij ligji që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave kushtetuese dhe ligjore dhe mbrojtjes së parimit të mosdiskriminimit dhe përfaqësimit përkatës dhe të drejtë të pjesëtarëve të bashkësive për lëndën që është në procedurë, pa marrë parasysh llojin dhe shkallën e procedurës në vijim, para organeve nga neni 2 të këtij ligji.

Lidhur me çështjen për sigurimin, respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave kushtetuese dhe ligjore dhe parimeve të mosdiskriminimit dhe përfaqësimit adekuat dhe të drejtë të pjesëtarëve të bashkësive, Avokati i popullit në kuadër të kompetencës së tij, me iniciativë të vetë mund të ofroj rekomandime, mendime dhe kritika në organet nga neni 2 të këtij ligji.

Neni 29

Avokati i popullit, në kuadër të kompetencës së tij i përcjell gjendjet lidhur me garantimin, respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve dhe respektimin e parimeve të mosdiskriminimit dhe përfaqësimit adekuat dhe të drejtë të pjesëtarëve të bashkësive, dhe me kryerjen e vizitave dhe shikimeve në organet nga neni 2 të këtij ligji.

Neni 30

Avokati i popullit mundet deri te propozuesit e autorizuar të ngrejë iniciativë për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve dhe akteve tjera nënligjore dhe harmonizimin e tyre me marrëveshjet ndërkombëtare, të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë.

Avokati i Popullit mund të paraqesë propozim në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjeve dhe kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë të rregullave ose akteve të përgjithshme.

Neni 31

Avokati i popullit i përcjell gjendjet e respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave kushtetuese dhe ligjore të personave, në organe, organizata dhe ente, në të cilat liria e lëvizjes është e kufizuar.

Avokati i popullit përcjell sidomos gjendjen e respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të të arrestuarve, të paraburgosurve dhe të personave që vuajnë dënimin me burg ose masën edukative-përmirësuese në entet ndëshkuese-përmirësuese dhe edukative-përmirësuese.

Vizitat dhe inspektimet nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, Avokati i popullit mund t'i bëjë në çdo kohë, pa paralajmërim dhe leje paraprake, si dhe të bisedojë me personat e vendosur në këto organe, organizata ose ente, pa praninë e personave zyrtarë.

Personat e privuar nga liria kanë të drejtë që parashtrësën t'ia dorëzojnë Avokatit të popullit dhe të marrin përgjigje në zarf të mbyllur, pa e kontrolluar personi zyrtar i

organit, organizatës apo entit në të cilin janë të vendosur dhe të marrin përgjegje në zarf të mbyllur pa kontroll të personave zyrtarë.

Neni 32

Kur Avokati i popullit do të konstatojë se janë cenuar liritë dhe të drejtat kushtetuese dhe ligjore të paraqitësit të parashtrës nga organet e neni 2 të këtij ligji, ose nëse janë bërë parregullshmëri të tjera, mundet:

- të japë rekomandime, propozime dhe mendime për mënyrën e evitimit të shkeljeve të konstatuara;
- të propozojë që sërish të zbatohet procedura e caktuar në pajtim me ligjin;
- të ngrejë procedurë disiplinore kundër personit zyrtar, përkatësisht përgjegjësit dhe të paraqesë iniciativë për ngritjen e procedurës disiplinore kundër personit zyrtar ose personit përgjegjës, dhe
- t'i paraqesë kërkesë prokurorit publik kompetent për ngritjen e procedurës për konstatimin e përgjegjësisë ndëshkuese.

Neni 33

Kur Avokati i popullit do të konstatojë se janë cenuar liritë dhe të drejtat kushtetuese të paraqitësit të parashtrës, nga organet e administratës shtetërore dhe nga organe dhe organizata të tjera që kanë autorizime publike, ose se është cenuar parimi i mosdiskriminimit dhe përfaqësimit përkatës dhe të drejtë të pjesëtarëve të bashkësisë në organet e pushtetit, organet e njësisive të vetadministrimit lokal dhe enteve dhe shërbimeve publike ose nëse janë bërë parregullshmëri tjera dhe nëse vlerëson se ekzekutimi i aktit administrativ do të prodhojë dëm të pakompensueshëm për të drejtën e personit të interesuar, do të kërkojë:

- shtyrje të përkohshme të ekzekutimit të aktit administrativ deri në vendimin e shkallës së dytë, dhe
- shtyrje të përkohshme të ekzekutimit të aktit administrativ deri në marrjen e vendimit nga gjykata kompetente.

Organet nga neni 2 të këtij ligji janë të obliguara që menjëherë e më së voni në afat prej tre ditësh nga dita e pranimit të kërkesës të dorëzuar nga Avokati i popullit, ta sjellin dhe ta dërgojnë deri te Avokati i popullit vendimin me të cilin akti juridik është shtyrë përkohësisht për ekzekutim.

Organet kompetente janë të obliguara që pas përfundimit të procedurës vendimin t'ia dorëzojnë edhe Avokatit të popullit.

Neni 34

Organet nga neni 2 të këtij ligji janë të obliguara ta njoftojnë Avokatin e popullit për masat e ndërmarrura për zbatimin e kërkesave, propozimeve, mendimeve apo rekomandimeve të tij, në afat të cilin do ta caktojë ai, e më së voni në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës së dorëzuar nga Avokati i popullit.

Nëse organi nuk e njofton Avokatin e popullit konform paragrafit 1 të këtij neni ose nëse konkluzat, kërkesat, propozimet, mendimet ose rekomandimet e tij i pranon vetëm pjesërisht, Avokati i popullit me raport të posaçëm e informon organin më të lartë të drejtpërdrejtë, funksionarin që udhëheq me organin nga neni 2 i këtij ligji ose Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, dhe nëse këta nuk i ndërmarrin masat e nevojshme, atëherë e informon Kuvendin e Republikës së Maqedonisë.

Avokati i popullit mundet, kur është konstatuar cenimi i të drejtave kushtetuese dhe ligjore, me harxhim të organit nga paragrafi 2 i këtij ligji të cilit i përket lënda, rastin ta publikojë në mjetet e informimit.

Neni 35

Nëse organet nga neni 2 të këtij ligji veprojnë sipas kërkesave, rekomandimeve, mendimeve dhe propozimeve të nenit 34 të këtij ligji në afatin e caktuar, Avokati i popullit do të konstatojë se procedura ka përfunduar dhe për këtë do ta njoftojë menjëherë paraqitësin e parashtrësës.

IV. PUBLICITETI NË PUNË

Neni 36

Për shkallën e sigurimit të respektit, përparimit dhe mbrojtjes së të drejtave kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve dhe për respektimin e parimeve të mosdiskriminimit dhe përfaqësimit adekuat dhe të drejtë të pjesëtarëve të bashkësive nga ana e organeve nga neni 2 të këtij ligji, Avokati i popullit e informon Kuvendin e Republikës së Maqedonisë me raport vjetor.

Raportin nga paragrafi 1 të këtij neni Kuvendi i Republikës së Maqedonisë e shqyrton në mledhjen e Kuvendit, ku doemos marrin pjesë anëtarët e Qeverisë të Republikës së Maqedonisë, përkatësisht përfaqësuesit e saj.

Raporti i Avokatit të popullit detyrimisht publikohet në mjetet e informimit publik.

Neni 37

Avokati i popullit, për punët nga kompetenca e tij, organeve të njësive të vetadministrimit lokal në rajonin e të cilave është e organizuar zyra si njësi organizative e Avokatit të popullit, mund t'u dërgojë raport të posaçëm.

Raportet e posaçme nga paragrafi 1 të këtij neni, lajmërimet dhe veprimet tjera të ndërmarrura, Avokati i popullit mund t'i publikojë në mjetet e informimit publik.

V. POZITA JURIDIKE E AVOKATIT TË POPULLIT

Neni 38

Avokati i popullit dhe zëvendësit e Avokatit të popullit nuk mund të merren në përgjegjësi për mendimin e dhënë dhe veprimet, masat dhe aktivitetet e ndërmarrura në kryerjen e funksionit të tij.

Neni 39

Avokati i popullit, zëvendësit e Avokatit të popullit dhe të punësuarit në shërbimin profesional kanë legjitimacion zyrtar.

Formularin, përmbajtjen, procedurën dhe mënyrën e dhënies, shfrytëzimit dhe marrjes së legjitimacionit zyrtar me akt të përgjithshëm e rregullon Avokati i popullit.

Neni 40

Avokati i popullit dhe zëvendësit e Avokatit të popullit të cilët deri në zgjedhjen e tyre kanë qenë në marrëdhënie pune, kanë të drejtë që në afat prej 30 ditësh nga ndërprerja e mandatit të kthehen në vendin e punës e cila i përgjigjet shkallës së tyre të përgatitjes profesionale.

Neni 41

Avokati i popullit, zëvendësit e Avokatit të popullit dhe të punësuarit në shërbimin profesional të Avokatit të popullit kanë të drejtë dhe obligim për aftësim dhe përsosje të përhershme profesionale.

Për nevojat e aftësimit dhe përsosjes profesionale sigurohen mjete të posaçme nga pjesa e buxhetit, të destinuara për Avokatin e popullit.

Neni 42

Si të drejta të posaçme të Avokatit të popullit dhe zëvendësve të Avokatit të popullit, gjatë kryerjes së funksionit, konsiderohen:

- e drejta të hyjnë dhe të kenë qasje të lirë në stacionet, aeroportet dhe portet, vetëm duke e treguar legjitimacionin zyrtar;
- e drejta për shfrytëzim pa pagesë të komunikacioni publik, tokësor ose të liqeneve në territorin e Republikës së Maqedonisë, dhe
- e drejta për mbrojtje të veçantë të personalitetit të tij, të familjes dhe pronës, me kërkesë të tij drejtuar policisë në vendin e banimit, çdo herë kur për këtë ekzistojnë arsye serioze për sigurinë e tij.

VI. SHËRBIMI PROFESIONAL

Neni 43

Aktet e përgjithshme për organizimin e punës dhe sistematizimin e vendeve të punës me të cilat përcaktohet lloji dhe numri i nëpunësve shtetëror dhe punëtorëve dhe detyrat e tyre të punës, i nxjerr Avokati i popullit.

Neni 44

Për kryerjen e detyrave nga kompetencat e Avokatit të popullit organizohen zyrat vijuese si njësi rajonale organizative të Avokatit të popullit:

1. Zyra e Avokatit të popullit në Tetovë;
2. Zyra e Avokatit të popullit në Kërçovë;
3. Zyra e Avokatit të popullit në Shtip;
4. Zyra e Avokatit të popullit në Strumicë;
5. Zyra e Avokatit të popullit në Kumanovë, dhe
6. Zyra e Avokatit të popullit në Manastir.

Me zyrat e Avokatit të popullit udhëheq zëvendësi i Avokatit të popullit.

Avokati i popullit me akt të përgjithshëm më për së afërmi e rregullon mënyrën e punës dhe numrin e të punësuarve në zyrat e Avokatit të popullit, të cilat i kryejnë punët nga kopetencat e Avokatit të popullit.

Neni 45

Për shkak të mbrojtjes më efikase dhe më të sukseshme të të drejtave kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve në sfera të caktuara, Avokati i popullit mund të organizojë dhe të formojë sektorë.

Avokati i popullit me akt të përgjithshëm më për së afërmi e rregullon mënyrën e punës dhe numrin e të punësuarve nëpër sektorë, të cilët do t'i kryejnë punët në sferën që janë në kompetencë të Avokatit të popullit.

Neni 46

Avokati i popullit nga radhët e nëpunësve udhëheqës shtetërorë emëron sekretarin e përgjithshëm.

Mandati i sekretarit të përgjithshëm të Avokatit të popullit zgjat aq sa zgjat mandati i Avokatit të popullit.

Sekretari i përgjithshëm i Avokatit të popullit udhëheq me shërbimin profesional.

Neni 47

Avokati i popullit për punën e tij nxjerr Rregullore për punën e Avokatit të popullit.

Me Rregulloren për punë të Avokatit të popullit rregullohen më për së afërmi mënyra e punës dhe procedura para Avokatit të popullit.

Rregullorja për punë e Avokatit të popullit shpallet në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë“.

VII. MJETET PËR PUNË

Neni 48

Avokati i popullit për kryerjen e funksionit të tij, në shërbimin e tij ka resurse adekuate, mjete dhe personel.

Mjetet për punë të Avokatit të popullit sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Kuvendi veças e voton pjesën e destinuar për Avokatin e popullit në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë.

Neni 49

Rrogat dhe kompensimet tjera të Avokatit të popullit dhe zëvendësve të Avokatit të popullit përcaktohen me ligj.

VIII. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 50

Rregullorja për punë e Avokatit të popullit dhe aktet për organizimin e punës dhe sistematizimin e vendeve të punës do të harmonizohen me dispozitat e këtij ligji në afat prej 6 muajsh nga dita e hyrjes së ligjit në fuqi.

Akti për mënyrën e realizimit të të drejtave të posaçme të Avokatit të popullit, të zëvendësve të Avokatit të popullit dhe personave të autorizuar nga Avokati i popullit nga

neni 42 i këtij ligji dhe akti për mënyrën e punës dhe numrin e të punësuarve në njësitë organizative të Avokatit të popullit nga neni 44 paragrafi 3 të këtij ligji, do të nxirren në afat prej 6 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Vendimin për numrin e zëvendësve të Avokatit të popullit nga neni 5 paragrafi 2 të këtij ligji e merr Kuvendi i Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 51

Njësitë organizative do të fillojnë punën më së voni në afat prej 6 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 52

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji pushon të vlejë Ligji për Avokatin e popullit ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 7/97).

Neni 53

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë".